



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Raion / Municipality of Rahovec  
RAHOVEC / RAHOVCE



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/22 Nr. ifaq/Br.estr./No. pg 386

Data/Datum/Date 28.10.2022

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja 1) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.12 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. Prot. 5558-2/22 të datës 06.10.2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.28.10.2022 miraton këtë :

### V E N D I M

#### Për miratimin e Programit komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025

1. Me këtë vendim miratohet Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025 në Komunën e Rahovecit.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Programi komunal tre vjeçar për banim 2022 - 2025 në Komunën e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01Nr. 374/22 i datës 23.09.2022.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

#### KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.386/22  
Datë: 28.10.2022

